



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Menaxhimit Financiar

Pukë, më 29.01.2026

Nr. 17/prot

PROJEKT-VENDIM

Nr. 2, Datë 29.01.2026

PËR

“PËRCAKTIM PËRDORIM FONDI (GRANT PËRFORMANCE), ME BURIM FINANCIMI I HUAJ”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", udhëzimet e përbashkëta, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendorë numër 20, dhe 01, datë.11.07.2025 "Për kriteret ,procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025", në shkresën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr.764 prot, datë.19.12.2025 "Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025",

Këshilli i Bashkisë Pukë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

I - Përdorimin e fondit të grantit të performancës me burim financimi i huaj si më poshtë:

- a- Shuma e gantit për përdorim është 7.666.543 (shtatëmilion gjashtëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqindë e dyzet e tre) lekë
- b- Ky fond të përdoret për shpenzime kapitale, në llogarinë ekonomike 231, me kapitull 02(financim i huaji),në strukturën Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore, Kod Programi 08220 për " Mobilim Pallatit kulturës Ndue Shyti " në Bashkinë Pukë.

II - Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtores e Finances

Fiqirete Latifi

Juristi

Aida Sinani

KRYETARI

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Menaxhimit Financiar

Pukë, më ____ 2026

Nr. ____ prot

RELACION

Për miratimin e buxhetit për “ Mobilim Pallatit kulturës Ndue Shyti ” Bashkia Pukë.

DREJTUAR :Këshillit Bashkiak Pukë

Të nderuar këshilltare

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, udhëzimet e përbashkëta,të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendorë numër 20, dhe 01, datë.11.07.2025 “Për kriteret ,procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025”,

Bashkisë Pukë me shkresën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr.764 prot,

datë.19.12.2025 “Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025”, i është akorduar grant performance me financim te huaj 7.666.543 leke.

Duke qene se per vitin 2026 bashkia Pukë ka projekt rikonstruksionin e Pallatit te kulturës “Ndue Shyti ” ,për ta bere atraktiv dhe bashkohore është domosdoshmeri dhe mobilimi me të gjithë aksesoret e nevojshem të te gjithë ambjenteve që do ju nenshtrohen rikonstruksionit.

Granti i performancës me burim financimi i huaj,do përdorët për shpenzime kapitale, në llogarinë ekonomike 231, me kapitull 02(financim i huaji),në strukturën Trashëgimia Kulturore, Eventet

Artistike dhe Kulturore, Kod Programi 08220 ne vleren 7.666.543 leke
Duke ju falenderuar ju ftojme te miratoni e projekt vendimit .

Hartuesi i relacionit
Fiqirete Latifi

